



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2021:031244

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731140

**E.nr.768/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: D.Q., F.R., L.M. A.F. dhe M.R., të cilët i përfaqëson av Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, dhe shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 24.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.768/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.768/23, të datës 22.09.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, te pagave jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit me numër C.nr.261/21, të datës 06.10.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 31.08.2022, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,983.50 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorët.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.768/23, më datë 24.05.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**